L I G J
Nr.9004, datë 13.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR PROJEKTIN "FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË SHQIPËRINË E MESME, KOMPONENTËT BERAT DHE KUÇOVË""

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Shqipërinë e Mesme, komponentët Berat dhe Kuçovë"", me një hua prej 6 646 794, 46 Euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3718 datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR

("Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujrave të zeza në Shqipërinë e Mesme-komponentët Berat dhe Kuçovë"- për vitin 2000)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 23 qershor 2000
ranë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një hua me vleftë prej deri në 6.646.794,46 eur (gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër 46/100 euro) për projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujrave të zeza në Shqipërinë e mesme-komponentët Berat dhe Kuçovë", kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se

projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragtrafin 1, mund të zëvëndësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose një fond garantues i kredive për ndërmarrjet e mesme, ose një masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose një masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë t'i marrë Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi, për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma financimi, për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masat përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 3, në rast se nuk përdoren për masa të tilla, do të kthehen në hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, si dhe marrësve të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontrata përkatëse për huanë nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron, më datë 31 dhjetor 2008.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës që do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren ne Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huasë; nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 11 dhjetor në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.